

Në periudhën Prill-Maj 2016, shtetasit shqiptarë Taulant Haxhiraj, Shkëlqim Koçiaj, Reshat Rradhima, Xhovalin Baco etj, në territorin e Zonës Administrative Vlorë, pasi siguruan më parë sipërfaqe toke, në pyll apo kullota, në pronësi të shtetit ose të personave privatë, kultivuan në to bimë narkotike të llojit Cannabis Sattiva. Kultivimi u krye në parcela të madhësive të ndryshme, në sasi nga 4500 deri në 5000 rrënjë bimësh narkotike. Për kultivimin, mbarëvajtjen e aktivitetit dhe ruajtjen e tij, ata aktivizuar një numur personash që u sistemuan në kasolle të ndërtuara pranë parcelave.

Krahas veprimtarisë kultivuese, personat e mësipërm vendosën lidhje me punonjës të policisë vendore, shtetasit Renato Avdyli etj., duke ofruar këta të fundit garancinë e tyre, kundrejt përfitimeve të padrejta monetare, për mbarëvajtjen e aktivitetit, nëpërmjet mosdhënies së informacioneve në strukturat përkatëse të policisë në lidhje me vendodhjen e parcelave me bimë narkotike, nëpërmjet shmangies së asgjësimit të bimëve si dhe, nëpërmjet dhënies së informacioneve personave të përfshirë në veprimtarinë kriminale për lëvizjet dhe kontrollet e ushtruara nga policia.

Në datë 18.10.2017, në banesën e shtetasit Armand Koçerri, ndodhur në fshatin Babicë e Vogël, Vlorë, gjatë kontrollit të ushtruar në të, u gjet sasia prej 3 978 kilogram lëndë, me erë dhe karakteristika të bimës narkotike Cannabis Sattiva, ndërsa në ambientet e Fabrikës së Vajit, në pronësi të shtetasit Florian Habilaj, u gjet mjeti lundruar, gomone, me mbishkrimin "Wave", së bashku me një motorr dhe karelin mbajtës. Në banesën e shtetasit Armand Koçerri u gjet edhe një armë gjahu e llojit çifte dhe, një sasi fishekësh.

Autoritetet Italiane të Drejtësisë, duke filluar nga Viti 2013 e në vazhdim, hetuan shtetasit Mosi Habilaj, Nezar Seiti etj si dhe bashkëpunëtorët e tyre si anëtarë të një grupi kriminal në fushën e trafikimit të narkotikëve. Në kuadër të këtij hetimi, u bë e mundur sekuestrimi, së fundmi, i sasisë prej 3.5 tonë lëndë narkotike e llojit Cannabis Sattiva, arrestimi me cilësinë e të dyshuarit e shtetasve Moisi Habilaj etj. dhe shpallja në kërkim ndërkombëtar e shtetasit Nezar Seiti. Shtetasi Moisi Habilaj, së bashku me shtetasit Nezar Seiti, Florian Habilaj, Matan Matani etj, që nga Prilli 2017 e në vazhdim, u hetuan nga Prokuroria pranë kësaj Gjykate për veprën penale të trafikimit të narkotikëve.

Hetimet e autoritetit të drejtësisë Italiane e kishin filluesën e tyre tek një veprimtari hetimore, e kryer në kuadër të procedimit penal Nr.4942/12 R.G.N.R (Operacioni "Odissea 2012") ndaj një organizate të degëzuar kriminale, që merrej me trafikimin ndërkombëtar të lëndëve narkotike, kryesisht marijuanë, në aksin Shqipëri-Itali. Nga hetimet e kryera ndaj shtetasit shqiptar Erson Zhuka, element kyç i organizatës që operonte në territorin e Raguzës, kishin rezultuar kontakte të shumta me bashkatdhetarin e tij, shtetasin Moisi Habilaj. Mbi këtë fakt, ndaj shtetasit Moisi Habilaj filloi përdorimi i mjeteve teknike të hetimit dhe rezultoi si ai ishte importues me shumicë i lëndëve narkotike që vinin nga Shqipëria. Në aktivitetin e tij, Moisiu ndihmohej nga shtetasi tjetër shqiptar i thirrur "Daja" dhe i identifikuar më pas si Sabaudin Çelaj. Përgjimi i komunikimeve të numrave telefonikë në përdorim të Moisi Habilaj dhe Sabaudin Çelaj njoftoi dhe mundësoi identifikimin e subjekteve të tjera që bënin pjesë në këtëorganizatë, Angelo Busacca, Antonino Riela, Florian Habilaj, Maridian Sulaj dhe Neizar Seiti si dhe, arrestime në flagrancë e sekuestime të shumta të sasive të mëdha të lëndëve narkotike, konkretisht: në datë 25.10.2013, në Augusta, u sekuestruan 1650 Kg. marijuanë; në datë 27.02.2014, në Palagonia, u sekuestruan 289,7 Kg. marijuanë; në datë 29.07.2014, në Catania, u sekuestruan 293,5 Kg. marijuanë; në datat 8-9 Maj 2015, në Risposto, u sekuestruan 880 Kg. marijuanë, 2 armë mitraloz të tipit Kalashnikov AK47 si dhe, 87 plumba të kalibrit 7.62x39.

Risposto, u sekuestruan 880 Kg. marijuanë, 2 armë mitraloz të tipit Kalashnikov AK47 si dhe, 87 plumba të kalibrit 7.62x39.

Në raportin përmyllës të veprës penale, datë 15.11.2016, Guardia di Financa (GDF), që operonte në procedimin e ri Nr.15431/2016 N.R, me autorizimin e P.GJ. Nr.Prot. 642200 datë 23.11.2016, evidentoi se, në përfundim të veprimtarisë hetimore të zhvilluar në kuadër të procedimit penal Nr.15353/13, autoriteti gjyqësor sinjalizohej për 41 subjekte, me shtetësi shqiptare dhe italiane, si pjestarë të një organizate kriminale, që kishte si qëllim trafikimin ndërkombëtar të marijuanës dhe që operonte në aksin Siçili-Shqipëri.

Hetimet e kryera nga G.O.A zbuluan strukturën e organizatës, e rezultuar e ndërtuar në disa grupime, të lidhur mirë me njëri tjetrin nëpërmjet disa prej anëtarëve të tyre, mes të cilëve personi shqiptar me precedent penal Erson Zhuka dhe, mënyrën e përdorur për importimin e drogës nga Shqipëria, e rezultuar nëpërmjet detit (kryesisht grupimi i drejtuar nga Moisi Habilaj), që mundësoi sekuestrime të përsëritura të lëndëve narkotike të tipit marijuana, të llogaritura në total 3 687 Kilogram. Rezultoi, nga hetimi, intensifikimi i udhëtimeve nga Qershori 2015 deri në Tetor 2016 që Moisi Habilaj dhe bashkëpunëtorët e tij shqiptarë më të ngushtë, Maridian Sulaj dhe Nezar Seiti, ndërmorrën nga dhe drejt Siçilisë para dhe pas mbërritjes së ngarkesës me lëndë narkotike. Këto udhëtime, krahas mbledhjes së porosive për marijuanë dhe pagesave të saj, kryheshin me qëllim identifikimin e vendeve ku do të dislokoheshin mjetet lundruese që transportonin ngarkesat e mëdha si dhe, të vendeve të përshatshme për magazinimin e tyre.

Në kryerjen e veprimtarisë kriminale të trafikimit, vëllezërit Moisi e Florian Habilaj siguruan mbështetjen e shtetasit Sokol Bode, Shef i Stacionit të Policisë Kufitare Dhërmi (në periudhën nga data 16.12.2013 deri në datë 08.05.2016), i cili, duke përfutuar nga detyra e tij funksionale, u siguroi atyre zhvillimin e lirshëm të aktivitetit, nëpërmjet shmangies së kontrolleve policore. Në aktivitetin e tij kriminal, Sokol Bode, krahas bashkëpunimit me anëtarët e grupit kriminal, bashkëpunoi edhe me punonjësit e policisë, Jaeld Cela, Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë, Vlorë dhe, Gjergji Kohila, Shef Sektori për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiqeve në të njëjtën Drejtori. Në bashkëpunim me njëri-tjetrin, ata garantuan dhe mbështetjen kultivimin e bimëve narkotike dhe, më pas, trafikimin jashtë territorit Shqiptar.

Në datë 06.05.2015, rreth orës 01:00, peshkarexha "FATIMA", në të cilën ndodheshin shtetasit italianë Rosario Giulianos dhe Giuseppe Grecos, mbërriti në ujërat territoriale shqiptare. Pas njoftimit me telefon, tek ata shkoi mjeti lundrues, në të cilin ndodhej Moisi Habilaj. Ky i fundit bëri shoqërimin e tyre drejt brigjeve shqiptare. Moisiu u dha shtetasve italianë udhëzimet për veprimet që do të kryheshin (fillimisht hedhja e karburantit të nevojshëm për rrugën e kthimit dhe, më pas, ngarkimi i lëndës narkotike) dhe, i siguroi se gjithçka do të shkonte mirë për shkak të mbështetjes së policisë lokale dhe të një punonjësi të kontrollit detar, pranë Centralit Operativ në Tiranë, që siguroi futjen, pa u vënë re nga radarët, e peshkarexhës. Pas ngarkimit të lëndës narkotike, peshkarexha u largua. Ajo mbërriti në shtetin Italian ku, lënda narkotike u sekuestrua.

II. Rrethana Procedurale.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në datë 08.07.2016, regjistroi procedimin penal Nr.134/2016, për veprat penale "Kultivimi i bimëve narkotike" dhe, "Grupi i strukturuar kriminal", të parashikuara nga nenet 284 dhe 333/a të Kodit Penal. Regjistrimi i këtij procedimi u bë mbi bazën e të dhënave të grumbulluara nga

Policia Gjyqësore në Prokurorinë pranë kësaj Gjykate, e cila, në bashkëpunim me organet ligjzbatuese në vend, mundi të sigurojë informacione mbi aktivitetin kriminal të disa grupe personash, shtetas shqiptarë, të rezultuar si grupe të strukturuar kriminalë, në fushën e kultivimit të bimëve narkotike.

Në datë 29.04.2017, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë regjistroi procedimin penal Nr.164/2017 për veprën penale “Trafikimi i narkotikëve”, në bashkëpunim, e parashikuar në nenin 283/a paragrafi 2 i Kodit Penal. Regjistrimi i këtij procedimi u bë mbi bazën e informacioneve referuese të shërbimeve të policisë gjyqësore të Seksionit kundër Narkotikëve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, sipas të cilëve shtetasit Nazer Seitaj, Moisi Habilaj, Florjan Habilaj dhe Matan Matani ushtronin aktivitet kriminal në fushën e trafikimit të narkotikëve.

Në datë 25.09.2017, duke arsyetuar se disa prej personave që hetoheshin në kuadër të procedimit penal Nr.134/2016 (ndërkohë që për disa prej tyre, Renato Avdyli, Shkëlqim Koçiaj, Xhovalin Baco, Marjus Bajrami, Reshat Radhima, Taulant Haxhiraj, Klajdis Imeri etj, u përfunduan hetimet dhe çështja u paraqit për gjykim) ishin të përfshirë edhe në trafikimin e lëndëve narkotike së bashku me shtetasit Moisi Habilaj, Florian, Habilaj, Nazer Seitaj dhe Matan Matani, bazuar në nenin 79 gërma “b” të Kodit të Procedurës Penale, prokurori i çështjes vendosi bashkimin e procedimeve Nr.134/2016 dhe Nr.164/2017 në një procedim të vetëm, Nr.134/2016.

Në datë 17.10.2017, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë regjistroi procedimin penal Nr.313/2017 për veprat penale Trafikimi i narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal dhe, “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë ose i të zgjedhurve vendorë”, të parashikuar, respektivisht, nga nenet 283/a paragrafi 2, 333/a dhe 260 të Kodit Penal, duke urdhëruar, njëkohësisht, regjistrimin e emrit të shtetasit Saimir Tahiri si person nën hetim për llogari të këtij procedimi.

Regjistrimi i procedimit të mësipërm u bë mbi bazën e të dhënave të përfuara nga media, në lidhje me faktin e arrestimit, nga autoritetet italiane të drejtësisë, të shtetasit Moisi Habilaj, si pjesë e një grupi kriminal që ushtronte aktivitet në fushën e trafikimit të narkotikëve. Sipas informacionit referues, që parapriu regjistrimin e procedimit, rezultoi se arrestimi i shtetasit Moisi Habilaj u krye në kuadër të hetimit në vazhdimësi nga autoriteti i drejtësisë italiane, në lidhje me faktin e sekuestrimit të sasisë prej 3.5 tonësh lëndësh narkotike. Në kuadër të hetimeve të kryera (gjithmonë sipas informacionit referues) u arrit të zbulohet se personi nën hetim Moisi Habilaj, së bashku me persona të tjerë, kishin bashkëpunuar me ish Ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri. Në datë 18.10.2017, u vendos bashkimi i këtij procedimi me procedimin Nr.134/2016.

Në datë 18.10.2017, shtetasi Armand Koçerri u arrestua në flagrancë, menjëherë pas gjetjes së sasisë së konsiderueshme të lëndës narkotike në banesën e tij. Në datë 19.10.2017, në regjistrin e njoftimit të veprave penale, në kolonën përkatëse përbrë procedimit penal Nr.134/2016, u regjistruan emrat e shtetasve Armand Koçerri dhe Nezar Seiti, si të dyshuar për kryerje të veprave penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, “Trafikimi i narkotikëve”, në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 283, 283/a dhe 333/a të Kodit Penal. Në datë 19.10.2017, u ndalua shtetasi Nezar Seiti. Mbi kërkesën e Prokurorisë pranë saj, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, caktoi ndaj shtetasve Armando Koçerri dhe Nezar Seiti masën e sigurimit personal “Arrest në burg”. Po kjo Gjykatë, caktoi ndaj shtetasit Sokol Bode të njëjtën masë sigurimi personal (e cila ende nuk është ekzekutuar).

Në datë 24.11.2017, u depozitua, në sekretarinë e gjykatës, kërkesa objekt gjykimi. Gjykimi i kërkesës, bazuar në nenin 278 të Kodit të Procedurës Penale¹ si dhe, në nenin 285 pika 1 (dispozita kalimtare) i Ligjit Nr.35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, është në kompetencën e kësaj gjykate.

Në nenin 75/a gërma “a” dhe “b” të Kodit të Procedurës Penale, të ndryshuar me Ligjin Nr.35/2017 datë 30.03.2017, parashikohet se vepra penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë ose i të zgjedhurve vendorë” dhe, çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal përfshihet në kompetencën lëndore të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, ndërsa sipas nenit 285 pika 1 e po këtij ligji, deri në krijimin e Gjykatës kundër Korrupsionit çështjet penale në kompetencën lëndore të saj do të gjykohen përkatësisht nga Gjykata për Krime të Rënda dhe gjykatat e rretheve gjyqësore.

Referuar nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, para ndryshimeve të bëra në të me Ligjin Nr.35/2017, gjykata e krimeve të rënda ishte kompetente për të gjykuar, ndërmjet të tjerave, edhe krimet e parashikuara në nenet 260, 283/a dhe 333/a të Kodit Penal. Meqënëse është duke u hetuar në kuadër të një procedimi penal të bashkuar për veprat penale “Trafikimi i narkotikëve”, në bashkëpunim, “Grupi i strukturuar kriminal”, “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë ose i të zgjedhurve vendorë”, hetimi ndaj tyre, referuar pikës 4 të dispozitës kalimtare të përmendur më sipër, do të vazhdojë të kryhet nga prokuroria e krimeve të rënda, ndërkohë që kjo Gjykatë është kompetente për të shqyrtuar dhe vendosur për të gjitha kërkesat e fazës së hetimit paraprak.

III. Provat

Prova materiale

Krahas akteve të regjistrimit të procedimeve penale dhe procesverbaleve ku dokumentoheshin provat materiale të gjetura dhe sekuestruara gjatë kqyrjeve dhe kontrolleve të ushtruara në datat 08.06.2016, 08.09.2016 04.10.2016, u paraqitën procesverbalet e kqyrjes, marrjes dhe sekuestrimit të provave, datë 18.10.2017, në lidhje me pakot me lëndë narkotike dhe mjetin lundrues gomone. Konkretisht, gjatë kontrollit të banesës së shtetasit Armand Koçerri, ndodhur në fshatin Babicë e Vogël, u gjet sasia e lëndës narkotike, e llojit Cannabis Sativa, me peshë totale 3 978 kg, ndërsa tek objekti “Fabrikë Vaji”, në pronësi të shtetasit Florian Habilaj, ndodhur po në këtë fshat, u gjet mjeti lundrues, gomone, me mbishkrimin “Wave”, së bashku me motorrin dhe karelin metalik. Nga kqyrja e aparateve telefonikë celularë dhe tabulatet telefonike, rezultoi një komunikim i shpeshtë midis Armand Koçerrit dhe Moisi Habilajt.

Prova Dokument

Referuar Strukturës Organike të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë, marrë në ekzekutim të kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë (Ref. Nr.10578 Prot. datë 09.11.2017) rezultoi se shtetasi Sokol Bode, gjatë periudhës nga data

¹ 1. Gjatë hetimeve paraprake, për rastet e parashikuara nga ligji, mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit, viktimitës dhe palëve private vendos gjykate.

2. Kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake, sipas paragafit 1 të këtij neni, shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar.

16.12.2013 deri në datë 08.05.2016 shërbeu me detyrën e Shefit të Stacionit në Stacionin e Policisë Kufitare Dhërmi. Referuar strukturës Organike të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë (Shkresa Nr.10403 Prot. datë 09.11.2017), rezultoi se shtetasi Jaeld Çela, gjatë periudhës nga data 05.09.2014 deri në datë 28.04.2017, kreu detyrën e Drejtorit të Policisë Vendore Vlorë dhe, shtetasi Gjergji Kohila, gjatë periudhës nga data 16.05.2015 deri në datë 28.04.2017, kreu detyrën e Shefit të Sektorit për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiqeve në të njëjtën Drejtori.

Nga të dhënat e dërguara nga Kompania "Vodafone", me Shkresën Nr.FRS/4186/LP, datë 16.11.2017, të dokumentuara në Procesverbal "I kqyrjes së të dhënave telefonike", rezultuan njoftime për pronësinë e shtetasve Jaeld Çela, Gjergji Kohila etj. mbi numra telefonikë celularë, konkretisht: Shtetasi Jaeld Çela, i datëlindjes 26.05.1977, kishte të regjistruar në emërin e tij numrat 069 46 83 312, 069 38 96 070 dhe 069 88 17 152 (inaktiv); shtetasi Gjergji Kohila, i datëlindjes 06.09.1980, kishte të regjistruar në emrin e tij numrat telefonikë: 069 29 87 653 (inaktiv); 069 35 31 437 (inaktiv); 069 34 92 477 (inaktiv); 069 72 43 306 (inaktiv); 069 57 20 222 (aktiv); 069 67 72 065 (aktiv); 069 77 81 816 (inaktiv); 069 83 05 020 (aktiv); 069 89 89 880 (aktiv); 069 84 77 545 (aktiv); 069 92 07 070 (inaktiv); 069 92 51 392 (inaktiv); 069 65 76 139 (inaktiv); 069 26 62 260 (aktiv).

Nga tabulatet telefonike dhe qelizat e përdorura gjatë thirrjeve telefonike, të kryera nga numrat telefonikë celularë 069 88 17 152, 069 46 83 312 dhe 069 38 96 070, të rezultuar të regjistruar në emër të shtetasit Jaeld Çela, njoftohet për komunikime të kryera me Florian Habilaj, Gentian Çeka dhe Orest Sota, konkretisht: Jaeld Çela, me numrin telefonik 069 88 17 152, në datë 28.01.2016, komunikoi me shtetasin Florian Habilaj, në numrin telefonik 069 20 26 777, ndërsa ky i fundit i dërgoi një mesazh Jaeld Çelës, në datë 31.12.2016. Gjithashtu, Jaeld Çela ka disa komunikime me shtetasin Gentian Çeka, duke përdorur ky i fundit numrin telefonik 069 88 83 788 si dhe, komunikime me shtetasin Orest Sota, duke përdorur ky i fundit numrat telefonikë 066 20 20 116 dhe 069 21 08 018.

Nga tabulatet telefonike dhe qelizat e përdorura gjatë thirrjeve telefonike, të kryera nga numrat telefonikë celularë 069 29 87 653, 069 35 31 437, 069 34 92 477, 069 57 20 222, 069 67 72 065, 069 83 05 020, 069 89 89 880, 069 26 62 260, 069 84 77 545, të rezultuar të regjistruar në emër të shtetasit Gjergji Kohila njoftohet për komunikime të kryera me Artan Habilaj, konkretisht Artan Habilaj, në datë 16.07.2016, me numrin telefonik 069 20 55 777, i dërgoi mesazh shtetasit Gjergji Kohila, në numrin telefonik 069 35 31 437.

Nga tabulatet telefonike dhe qelizat e përdorura gjatë thirrjeve telefonike, të kryera nga numrat telefonikë celularë 069 37 11 576, 069 37 11 575, 069 35 13, 195, 069 73 88 273 dhe 069 87 32 738, të rezultuar të regjistruar në emër të shtetasit Ermal Lulaj, rezultoi se në datë 11.08.2016, Ermal Lulaj, me numrin telefonik 069 35 13 195, i telefonoi shtetasit Artan Habilaj, në numrin telefonik 069 20 55 777.

Transkriptimet e komunikimeve telefonike të përgjuara të vlerësuara në unitet me të dhënat e përfuara nga akti i ekspertimit teknik të aparateve telefonikë celularë (kryer veprimet nga organi procedues, prokuroria) si dhe, transkriptimet e komunikimeve telefonike të ardhur në ekzekutim të letërporosisë dërguar autoritetit gjyqësor Italian, njoftojnë përfshirjen e shtetasve Jaeld Çela dhe Gjergji Kohila, në bashkëpunim me shtetasin Sokol Bode, në aktivitetin kriminal të kultivimit e trafikimit, nëpërmjet mbështetjes së ofruar, duke qënë ata në funksione të larta drejtuese në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë.

Sipas Aktit "Ekspertim Teknik i Telefonave", Nr.2273 datë 09.03.2017 (pika 5), aparati telefonik celular, i markës "BlackBerry", me Nr.Imei 356002056327402 (në opsionin "Të dhëna PDF"), jep të dhëna për komunikime me sms dhe mesazhe "chat", kryer nga i hetuari Taulant Haxhiraj, me persona të tjerë të paidentifikuar, në lidhje me kultivimin e lëndës narkotike. Gjatë komunikimeve, rezultojnë se personat me të cilët komunikojnë, i japin informacione për qënien e tij në hetim nga krimet e rënda, për ekzistencën e përgjimeve të kryera nga "Shik" (fjala për Shërbimin Informativ Shtetëror), për qënien në vëzhgim të vazhdueshëm etj, në lidhje me aktivitetin e kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal. Në veprimtarinë e tij, shtetasi Taulant Haxhiraj, sikurse rezultojnë nga hetimi i deritanishëm, ku gërshetohen përgjimet dhe vëzhgimet në terren, ka patur lidhje me të hetuarin Renaldo Avdulaj, kunatin e tij Gjergji Kohila dhe Drejtorin e Policisë Jaeld Cela, konkretisht:

2B53F044 "Agushi" 19-Sep-16 2:05:55 PM (UTC+0), 2B53F044 (Agushi)=>To: 2BCC0156 "Xheku I". Deleted: "U pleksa me këtë legenin, kunat e gj":

2B53F044 "Agushi" 19-Sep-16 2:07:42 PM (UTC+0), 2B53F044 (Agushi)=>To: 2BCC0156 "Xheku I". Deleted: "Po vlla ky gj me thot mos di".

B53F044 "Agushi" 19-Sep-16 2:09:17 PM (UTC+0), 2B53F044 (Agushi)=>To: 2BCC0156 "Xheku I". Deleted: "Dhe thash të pyesja njëher ty vlla se kam hall se kërcënova atë që ti me thoshe mos u pleks r".

Inicialet e përdorura "r" dhe "gj", dyshohet se i përkasin punonjësve të policisë Renaldo Avdulaj "r" dhe Gjergji Kohila "gj". Në funksion të fshehjes së identitetit të komunikuesve, janë përdorur gjithashtu: "Agushi", "Fiati" "Xheku", "Adidas" "Aliej", etj.

Messages Outgoing 16-Apr-16 7:34:13 PM (UTC+0) From: 2B53F044 "Agushi" To: 2B68CFBF "Aliej": "Atje e ka vllai me drejtorin", dyshohet se njëri prej komunikuesve ka siguruar mbështetjen me shumë gjasa të vetë drejtorit të policisë.

Messages Outgoing 16-Apr-16 7:29:29 PM (UTC+0) From: 2B53F044 "Agushi" To: 2B68CFBF "Aliej": "O vlla vend ka po akoma skan marr garanci ata kushot e ministrit", dyshohet se bëhet fjalë për sipërfaqe toke për kultivimin e bimës narkotike për të cilat pritet me sa duket, marrja e garancisë nga vëllezërit Habilaj.

Mesazhet e shkëmbyera (në datë 16.04.2016) nga komunikuesit 2B68CFBF "Aliej" dhe 2B53F044 "Agushi" (i arrestuari Taulant Haxhiraj), njoftojnë se ky i fundit mori garanci nga strukturat e shtetit, për të gjetur toka në zonën e fshatit Kuç, Vlorë, për kultivimin e bimëve narkotikëve, konkretisht: "Aliej: Andej, me garanci, ta moren përsipër, vlla? Agushi: Po ma moren vlla. Aliej: Apo në ajër?! Agushi: Po s'ka garanci, të saktë fare. Më thanë kaq pak do i mbrojnë?! Aliej: Po të vemë me, ka vend për të mëdha? Agushi: Po të saktë fare se kam, se mos i levizin? Aliej: Vlla, je marr vesh, vlla?! Agushi: O vlla, vend ka po akoma s'kan marr garanci ata kushot e ministrit...dhe të them garant e të del ndryshe....S'dua të të bëj garantin e të dal ndryshe, vlla. Aliej: Të marr vesh, vlla. Agushi: Më kupto se un e di si mendon ti, të hidhem, po një garanci ta marr, vllai. Dhe më ka thënë ai kushua jot, do sillte, do lidhej me njërin që ka baçe e garancinë me shtet e merrja un... se më ka dhënë ok për këtë na fshati Kuç, vij më ka thënë. Aliej: Është dhe ai, aty ku je ti, në të njëjtën zonë. Agushi: Po jo vlla, un i kam afër në Florë. Aliej: Të marr vesh. Agushi: Shteti ma jep garancinë të plot në Kuç. Më jep këtë gjë po s'kam njeri atje. Atje e ka vllai me drejtorin, të sigurt. Aliej: Ai ka

për të ngrën zogj, o të keqen vëllai, si ka për të hër punë. Agushi: Më tha ai në Kuç, vij sa të dush 30 përqind, këtyre dhe hajd ti vem vlla, po s'po gjej tokë. Ka vajt një na Flora në Kuç që ju ka dhën leje ky dhe, ai na Fr... që po bën të madhe. Pastaj kan vën pa leje. Po të gjejm tok atje vlla, të dal garant, vllai. Aliej: Të marr vesh vlla. Agushi: Jo vetëm në Kuç, Bolen, Kallarat, Vranisht, kudo në këto të del vllai garant, të mbrojtur e të sigurt, si më kan thën. Aliej: Po do fol me na një që ka tok, vlla. Po kta që dalin garant, sa përqint kërkojn vlla? Agushi: 30 përqind. Aliej: Po si i duan, gjëra apo lekë, vlla? Agushi: Gjëra ça lekësh! Aliej: Të marr vesh. Agushi: Sot që po flasim, më kanë lënë 80 kile mua në shpi atë të tyre. Aliej: Të marr vesh vlla.

Mesazhet e shkëmbyera (në datë 08.05.2016) nga komunikuesit 25C77E4A "Usta" dhe 2B53F044 "Agushi" (Taulant Haxhiraj) njoftojnë përcjelljen e shqetësimit të këtij të fundit për transferimin e një punonjësi të policisë nga Vlora në Shkodër, mbështetës i veprimtarisë së tyre. Duke e parë këtë njoftim në unitet me njoftimin e përfutur nga prova dokument, organika e Drejtorisë së Policisë Vendore Vlorë (përmendur më sipër), rezulton se bëhet fjalë për shtetasin Sokol Bode, konkretisht: "Usta: Ç'ph vëlla? Agushi: Ja sa po shkr me atë vlla. Usta: Ok, më thucj që të lëviz të paktën, vëlla. Agushi: Të më vdes djali, nuk të gënjej, më tha, ja do të them kur të nisem, po lëviz ti vlla, le të presi ai me mua. Usta: Ok. Agushi: O vlla, e hoqën atë, na këputën. Në Shkodër e çuan. Usta: O vëlla, e mora vesh. Agushi: Na këputen fare".

Mesazhet e shkëmbyera (në datat 22 dhe 23 Shtator 2016) nga komunikuesit 2B53F044 "Agushi" dhe 2C26AE10 "AdidaS" njoftojnë dhënien e informacioneve, të marra nga punonjës policie, për hetimin nga krimet e rënda, për përgjimet e "Shik" (Shërbimi Informativ Shtetëror) dhe, për vëzhgimet në vazhdimësi, konkretisht:

Datë 22.09.2016

"Agushi: O vlla, tani më erdhën, se jam në fshat... AdidaS: Ç'a ke bër, si po kalon? Ç'a bëhet andej, ke marr vesh na një gjë, ç'a bëhet? Agushi: O vlla qetësi. Këta jan zhdud të gjithë. AdidaS: Atë e ke takuar më, kur ta takosh prap atë shokun...ç'a të tha, të të thot na një gjë tjetër, e të na thotë na një gjë, ç'a duhet të bëjm ç'a s'duhet të bëjm, si ta kapim fillin që të zgjidhim kto ç'a jan. Ç'a kemi në dorë të bëjm? Agushi: Fola sot me atë shokun, më tha davo dhe dy ditë, vlla, se po i mbyll ai. AdidaS: Si po i mbyll ai? Se kuptoj. Agushi: Dhe do me jepni një drek, këtë më vuri gjobë, o vlla, di..., ishte me këta ai të Tr. AdidaS: Ku qe? Agushi: Do ju lë vetëm Shikun, tha, do t'i zgjidh unë. AdidaS: Po ata s'po bëjn asgjë, ç'a jo kshu po ashtu! Agushi: Në Florë, o vlla, po kuji do i bëjn, kan ik të gjith. AdidaS: Pse aty jan, mua me than jan aty. Agushi: S'ka njeri fare. ...ai tha, do të them, mos u duk dhe dy ditë, po ja se do mbyllen, Shiku do jet nëpër këmb, s'do takosh njeri. Kshu më tha të them vlla. Mase dhe jan o vlla, s'di gjë, ç'a më tha ky të them, vajti ky që rri un takoj atë që të thash, kushua jot. AdidaS: Mirë o vëlla, mirë. Agushi: Ç'a nuk i kish thënë! AdidaS: Ç'a? Agushi: Gjithë Flora vlla, ky ka një foto me mua, ja kishin treguar. Po i din të gjitha o vlla! AdidaS: Ç'a i kish thën, që thua, ç'a si kish thën? Agushi: Ç'a ham, ku pim dhe, për mua për ty...AdidaS: Si ç'a ham, ku pim? Po ç'a, thuani konkrete, o vlla. Po me ç'a merremi, ç'a bëj un ti, ke nis pun ku u kapën katër tonë. Me kë e ke nis. Po un kam frik mos ka fol ndonjë na ata në Itali. Se fiks mbas asaj erdhën këta. Po ata nuk faktojn dot gjë, than se nuk bëjn dot lidhjet tani. Agushi: Po ku di gjë unë, ... vetëm po ka pas list në xhep ai që është kapur...E marr vesh, vetëm e din me fjal, me gjëra, me fakte s'bëjn dot gjë. Se asnjë nuk takon me njëri tjetrin, kanë thën. Se ti thua piva kafe, tel nuk ke, vlla, vetëm foto. AdidaS: Po s'kam as tel as gjë, foto, vetem s'e di. Agushi: Ti je përgjegjës për vrasje dhe je në përgjim dhe të dolën këta. AdidaS: T'i mbaj, të na i tregoj

fotot ai, si si...? Agushi: Kshu më tha ky i Florës, ti je në pëgjim për një vrasje... në përgjim, tha, mund të jet gjith jetën. AdidaS: Për ç vrasje, nuk sqaroj më shumë, dhe ku i kam përgjimet, kur mi vun, unë një muaj jashtë! Agushi: Më sqaroj, vlla, i ke gjith kohën vlla dhe kur ke qen Brenda, tel na burgu. S'po themi për tani vlla. AdidaS: Po për ç nuk të thot më shumë, për ç më përgjojn, për ç jo? Si mund ti heqim kjo gjëra". Agushi: O vlla nuk i heq dot, nuk të ka policia, as duan t'ja din. Është Shiku vlla, dhe raportojn me qendrën, tha, në Tr. Po mos u shqetësoni, tha, ata atë pun kan. Le të mbajn, i thash un, po të ri andej. Po do vi ai, tha, prap qepen, tha deri sa te lodhen, tha, se nuk ndërhyt dot te ata, tha, jan spiuna, atë pun kan, ç dëgjojn e shkruajn, tha, ata shkruajn dhe për policin, tha. AdidaS: Po kta, tani, jan na krimet e rënda apo është Shiku, se s'po e marr vesh tani? Agushi: O vlla, jan na krimet e rënda, Po ata s'te njohin as ty as mua, asnjeri, jan oficeret e Shikut vlorë, që i shoqërojn këta, janë operacionalia. AdidaS: Po ky, ç tha ky tani, që do ti regulloj vet kjo fotot, kjo gjërat, une, thotë? Po përgjimet ambientale ç kan? Si do t'i heq ai? Agushi: O vlla, ç do si heq dot ai, po kemi ambientale te Shiku. AdidaS: Po ç do bëj ai, ç do heq? Si do ja bëjm, ç do bëhet? Po kemi apo s'kemi ambientale ne? Agushi: Ai po anashkalon mua, ty dhe nja dy të tjerë, sa të mbyllet, vlla, se me Shikun, ma tha, do i keni na mbas, vetëm s'do të finalizohet operacioni të jemi dhe ne. AdidaS: Po kta dy të tjerët, kush janë, i njojn? Si s'do të finalizohet operacioni, të jemi dhe ne!?! Do ta bëjn për të bër operacionin, ç do bëjn? Agushi: Do ta bëjn dhe ne s'do jemi, do ta mbyllin, po s'kan me kë, jan njoft të gjith, s'ka njeri fare. AdidaS: Kur ta bëjn? Po si ta bëjn kur s'ka njeri pasaj? Agushi: O vlla, po se di kujt i është prer fleta dhe pse si kapin. Se më tha, do bëjn arrestime dhe, tre oficer policie do arrestohen. AdidaS: Arrestohen! Jo arrestohen! Hahahahahaha. Mirë ja do i shikojn, S'di ç të besosh e ç jo, tani. Agushi: Po ashu është, o vlla, se bëjm dot të fortin, o vlla, se s'kemi gjë në dor. AdidaS: Për ç thua? Agushi: O vlla, që mos të ruhem na këtaAdidaS: Ok, vëlla".

Datë 23.09.2016

"Agushi: O vlla çpb? AdidaS: Hiç ç do bëj tani, po dal. Ç a hëre ti, mirë u gdhivët andej? Agushi: Po mir o vlla, ja vājta çova djalin në kopsht, rastësi takova një të krimeve, më tha po ty të kan prer fletën, më tha. Jo i thash, ç'ne un! Ç a thua, tha, ty.Jo, o vlla, më tha, u hapën që do priheshin, po as ti, më tha, as kushua nuk ju është prer gjë, tha, kur s'ka prova nuk mund të prihet asgjë, rrini të yet, me tha, kshu me tha kshu të them. Se un po lëviz nëpër Florë".

Të njëjtat njoftime përftoheshin edhe në mesazhet e shkëmbyera nga komunikuesit 2B53F044 "Agushi" dhe 2BCC0156 "Xheku 1" (datë 19.09.2016) konkretisht: "Xheku 1: Ç a bën, si je vlla? Agushi: O vlla, si të kam? Suksese për punën e re! Na shpija mir i ke? Fola pak me "gj". Më tha është një procedim, na k.r. Ç a të doli ty vlla, se me ka ik mendja keq fare. Të më falësh se u fut direkt në hallin tim, po qëkur ike ti me mori lumi mua, me këta legena që kan ngel këtu! Xheku 1: Unë hiç vlla. Mirë për zotin, shtyu këtej. Po me kujdes aty! Agushi: Po aty është më mir. Xheku 1: Mos u hap shumë, mos dil shumë vërdall! Po këtu mir vlla...Ti ç a hëre andej, mir dole, apo nuk ke mbaruar akoma? Agushi: Ma pren, o vlla Xheku 1: Ç a thua, hoho! Agushi: U pleksa me këtë legenin, kunat e "gj" Xheku 1: Unë nuk kisha ndonjë gjë vlla, vet të kërkova. Agushi: Dhe kan ruajt këtë dhe më kan hap problem gjith Flora, atje te mua vetëm këtë pren Xheku 1: Po ç a thua! Unë fola me atë shoqen qëparë. Po ç'farë halli kishte ajo, se s'kisha ku të flisja. Agushi: Po vlla, ky "gj" me thot mos dil. Do të them un, thotë, se janë një grup në Florë Xheku 1: Po mos të gënjejnë, apo bëjnë kot ata, për tu dhënë ndonjë gjë?! Agushi: Dhe thash të pyesja njëher ty vlla, se kam hall, se kërcënova atë që ti me thoshe mos u pleks "r" Xheku 1: Kë vlla? Agushi: Dhe ai thot, ky është gati për arrest.

Reni. Xheku 1: Kërceen Agushi: Legeni! Xheku 1: Ai? Agushi: I thash dua lekët, se më marrët në qaf! Xheku 1: Të bën presion, o vlla, për këtë problem. Agushi: Tani, më thon, na kan bër foto. Ka ardh Tirana, duan të të arrestojn. Ai është zhdukur, Reni. Xheku 1: Lëre se gënjejnë, ça thua ti, s'ka shans! Agushi: Se do ndalojn tre oficer policie, jam edhe un në këtë mes. Xheku 1: Kush të tha ty për mua që erdha këtë? Agushi: Po mir, më mir na këtu je, besoj. Po "gj"? Qëpar fola. Xheku 1: Po ç'ne, ra muabeti apo vet? Agushi: Po më sqaronte, a vlla, tu dish ti sa ndere ju kam bër na ana jote jo vet. më tha, po me atë ke fol, se sa her kërkonin nder permendeshe ti dhe si përfundim ma futën...Bota është portokalle. Xheku 1: Po thash, vlla, u bë keq aty, po të isha unë mase do kishim bërë ndonjë gjë. Se dhe ca shok që kisha unë mbaruan shpejt e shpëtuan, vlla. Se çave, tani në fund, i dogjën të gjith këta. Agushi: Po vlla, un vajta, mbloodha gjith Florën, te miku jot i parkuan. Ustai: Un me kamion, palidhje, për këta dhe ma pren mua për dy dit, mbaroja pun. e dogjën. Se mund ta kisha regulluar. po i vun flakën se un ju prishja pun. të pabes, vlla...".

Mesazhet e shkëmbyera ndërmjet komunikuesve 2B53F044 "Agushi" dhe 25CA0278 "Fiati" (ky i fundit dyshohet se përdorej nga Gjergj Kohilla), njoftojnë dhënien e informacioneve, nga ky i fundit, për hetimet e kryera, konkretisht: "Agushi: O vlla si je, ça bëhet? Po lëviz, vllai, nëpër Florë, po thjesh me familjen, s'bej asgjë, të dal normalisht vlla...se jam hap llafë, jam prer ca urdhër arresti, vlla, për mua, ate kushurin tim, e ca çuna të tjerë...apo llafë Florë? Fiati: Unë s'di gjë vëlla. Por duhet të ket prova që të priten urdhra arresti. Ju kan kapur gjë!? Po s'kan prova. s'ka urdhër arresti. Njerzit ju din në burg. Po me këto intriga që bëre ti me atë timin, çuditën kur ju shohin jashtë. Agushi: Ça intriga bëra un, o vlla?! Vetëm un s'bej intriga. Të përshëndeta qëpar, s'më pe. Mua ma hën intrigën, me morën në qaf, po varja o vlla, po të jet ndonjë gjë, më thuaj të ndërhy. Në Tr kam njerëz. Po ç'ne na din në burg, ne ça kemi bër apo bacja jon, ne përball i kishim, dhe është me 100 mijë rrenj, nuk i shikojn, kjo jona dukej! Hahhahaha. Fiati: Hahahahaha Agushi: O vlla, të rri vllai i qet në shtëpi, se vetëm te llafi jot kam besim. Fiati: Ri o vëlla. Unë kam sjell atë timin në punë. Po nuk është se dukej bacja. Dukeshit ju me shum se bacja. Sikur kishit 200 mijë. Agushi: Ok vlla, ore të pyes ty un, pa atë se pyes më un, varja iku ajo, rëndësi ka të jemi të qetë tani, vlla".

Datë 28.09.2016.

"Fiati: Ça bëre, mirë? Si ke qënë? Agushi: Mir vlla si je ti, tani e pashë. Fiati: Bëj kujdes nga nesër! Agushi: S'po e kuptoj vlla? Fiati: Se do kesh grupe nga nesër, nga pas! Agushi: Ça ka ndodh? Fiati: Kan ardhur këta të vëzhgimit, për atë që kishit... Agushi- Ka ndonjë rrezik se un asgjë s'bëj më. Ça do vëzhgojnë ata!? Kur çoj djalin në kopsht, vlla. Fiati: Po s'bën gjë. Ri në shtëpi, mos e vra mendjen. Agushi: Po vlla, asgjë s'po bëj më, i kam bër stop gjithëka. Fiati: Shko porosit ata djemtë që kishit lart, të ken kujdes, se do jen dhe ata në vëzhgim. Hiqu numrat e tel... Mos harro! Agushi: Ok vlla, sa do zgjas kjo, po ata s'merren me asgjë, nje punon kamarier, një në pik llojtoje, jam me pak llafë, hallexhinj, vlla...Fiati: E di, por thuaj të bëjn kujdes, s'ka problem. Kanë shkruajtur prap ata të Shikut. Agushi: Po un të dal nesër, vlla, normalisht jetën e përditshme? Fiati: Do ken ndonjë spiun brenda! Agushi: Po për ça do spiunoj tani, o vlla, as me asnjë nuk po tak, me...Fiati: Ok, mos u thuaj me kë flet ti, se flasin në tel ata, e s'na thon më gjë neve ata. Agushi: Të dal normal nesër un, vlla, jetën e përditshme apo të fshihem? Ok, pa merak, jo vlla, jo si e do i them. Fiati: Dil normalisht, mos e vra mendjen po s'bën gjë. Porositëm ata djemtë të rinë mirë! He, mos e vra mendjen fare. Agushi: Ok vlla, jo jo vlla asgjë, po të bëja do ishe i pari do të thoja, vlla dhe, do të pyes kur të filloj pun. Fiati- Ok".

Datë 02.10.2016.

“Agushi: Ç’ ishte ky lajmi, po lexoja s’ me pëlqeu, apo s’ ka lidhje? Fiati: S’ ka lidhje vëlla, ky për baxhanakët... Agushi: Ok vlla, për merak të pyeta vlla. Po, vlla”

Datë 19.09.2016.

“Agushi: O vlla, më ka bër merak ai...më jan shqetësuar ata në ship, nusja rrezik dështimi....A mund ta di ç’a kam? ...O vlla se ku s’kam pyet, s’ka gjë më thon. Fiati: Ka një procedim... Tek k.r... Keni qen në përgjim. Agushi: Po për ç’a o vlla... Për atë bae? Fiati: Jo për atë. Agushi: Po ç’ne un për gjëra të tjera! Fiati- Ai është çelur për disa persona nga Flora...Për kultivim...Nga këta persona që unë akoma se di kush janë, keni dalë dhe ju. Agushi: Dmth për kultivim...Jam. Fiati: Nuk është ndonjë gjë serioze... Por për siguri pasi nuk dim gjë tjetër. Agushi: O vlla, jam për kultivim, se ai më tha për vrasje...Ç’ne vllai! Fiati: Se këtu ka grupe vëzhgimi. Agushi: Me këto gjëra, qajnë nat dit në ship, i ka pataks. Fiati: Jo mor vëlla, ç’a vrasje! Agushi: O vllai im! Fiati: S’ka lidhje, asnjë vrasje vëlla... Hajde në shtëpi ri, mos e vra mendjen! Agushi: Po si i bëhet, o vlla?... Un jam bër si harbon! Fiati: Unë i thash vetëm të pastrojë shtëpinë...Dhe tele...Si kam thën gjë tjetër. Agushi: Rrugve do vin të i marrin, është prer fleta, nusja shtruar në spital...Më ka ik mendja. Fiati: Jo mor vëlla, s’ka flet...Flitet që do arrestohen nja tre policë... Ngaqë të kan bër një foto me të kur i ke dhën lekët...I thash të të lajmëronte...Të bëjë kujdes...Agushi: Mir o të keqen vllai dhe i thash jo këtu lekët, s’ka gjë tha. Fiati: Kthehu në shtëpi vëlla. Agushi: Po mos na marin, o vlla! Fiati: Po sikur i hoqëm të gjitha provat...Tek lekët... Vetëm aty mund të kapen. Agushi: Po i dhash për makinën...Fiati: Do ta justifikoni se keni shitur makin njëri tjetrit. Agushi: Po ore, vlla...Pse do na pyesin? Fiati: Ne tel keni folur...Apo keni qen të kujdesshëm? Agushi: Ç’a të kujdesshëm...Ai ma lëshonte...Fiati: Kshu ashu...po ç’a tu them unë vëlla?!...Ju sikur jeni 5 vjeç. Mir ai që është budalla po dhe ti pas atij! Agushi: Po un s’kam fol Isha i rezervuar se kam një jet, o vlla. S’jam djeg njëher. Këtij do jan ken bër kastile, hapej shum. Fiati: Po më zuri goja lesh me të. S’kam ç’i bëj vëlla! Fiati: Po perpiqem tani mos i mbyll...Agushi: Po si i bëhet ku duhet të ndërhyj...Të vete në ship, se ngela rrugve...Fiati: Shko në shtëpi! Agushi: Po ç’a thua o vll, ai të merr në qaf. Fiati: I hoqe tel? Agushi: Po vlla. Fiati: As mos i fol më! Agushi: Po ç’a thua, o vlla. Fiati: As mos kontakto më me të. Agushi: Lash fëmijet rrugve, isha mir...Fiati: Po as këtë tel s’ja mësove dot, idiotit?! Agushi: Po ku mer vesh ai, o vlla...Na mori luni. Fiati: Flet sikur ka mbjell domate...Qetësohuni! Fiati: Kishe folur në fb me Fjorin? Ke bër gabim...Po ty të kan ngatruar me ato grupet e vëzhgimit... Agushi: Dmth, në vend të atij, kan ruajt mua. Fiati: Ka mundësi mos ti flasësh më atij. Agushi: Dmth, mos të ndërhy në asnjë vend? Fiati: Jo vëlla, prit se do të them unë...S’jeni vetëm ju të dy, Jan disa persona. Kan ndërhyr ata. Agushi: Ok vlla, mos të dal fare. Fiati: Të presim. Agushi: Të ri dhe ca dit kshu deri sa të më thush ti? Fiati: Po mir është të rish dhe ca dit. Agushi: Ok vlla...Agushi: Po me Xhekun ke fol, vlla? Fiati: Po, e porosisja çdo ditë. Ku dija unë që ishte kalania ai. Po kam fol, ka ardhur në Tiran me punë...Agushi: Po duhet gjë për të ndërhyr, më thuaj. ..Fiati: Kujdes me tel. ..Agushi: S’kam tel më, vetëm këtë kam, vlla. Fiati: Hahahaha! Mir vëlla”.

Nga përgjimet e kryera nga autoriteti gjyqësor italian dhe të marra drejtpërdrejt, në ekzekutim të letërporosisë të dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë me Shkresën Nr.176/1 Prot, datë 18.10.2017, në zbatim të nenit 4, pika 2 gërma “b” të Marrëveshjes Dypalëshe, të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, si shtesë e Konventës Europiane për Ekstradimin, datë 13.12.1957 dhe, Konventës Europiane “Për Ndihmë të NdërsjelltëJuridike në Fushën, Penale”, datë 20.04.1959,

përftohen njoftime për mbështetjen e ofruar nga Sokol Bode në trafikimin e narkotikëve, të kryer nëpërmjet Peshkarexhës “Fatima”, e ndodhur nën përgjim ambjental, për sa më poshtë:

Rreth orës 01.00 të datës 06 Maj 2015, Peshkarexha “FATIMA“, në të cilën ndodheshin Giuliano dhe Greco, mbërriti në ujërat territoriale shqiptare. Tek peshkarexha u afrua një mjet lundrues, ku ndodhej Moisi Habilaj. Me të hipur në peshkarexhë, Moisi Habilaj u dha Giulianos dhe Grecos udhëzime në lidhje me operacionet që do të kryeshin pas pak, fillimisht për ngarkimin e karburantit që nevojitej për rrugën e kthimit dhe, më pas, për ngarkimin e lëndës narkotike, duke i siguruar për mbështetjen që kishin tek policia lokale dhe tek një punonjës i sallës operative qendrore, konkretisht: “Moisiu: ...tani të marrim naftën njëherë ... fillojmë me bidonat ... këtu je si në shtëpinë tënde ... boll!... në fillim marrim naftën dhe pastaj jemi në rregull ... nëse vjen dikush ... nuk kemi pse rrimë dy orë me ...sipër ... më kuptove? ... se kush dreqin e di kush vjen ... kush shkon ... ne jemi të kompletuar ama ... del ndonjë bastard...”; “...a e pe furgonin e policisë që kaloi? ... pak më parë?... janë të gjithë tanët këtu!...po mund të na dalë ndonjë qelbanik nuk i dihet!... ai mori në telefon se është salla ... si thuhet?... salla është në portin tjetër në kryeqytet ... ku janë ... (e pakuptueshme) ... dhe shikon çdo gjë ... edhe peshqit shikon nga atje ... sepse është shok i një shokut tonë “po si ka mundësi” ... përse e pyete “kush është kjo anija?” ... dhe ai tha “çfarë anijeje” (e pakuptueshme)... “po si ka mundësi që hyri një milje në ujërat territoriale greke?””.

Nisur nga gabimi që dy shtetasit italianë bënë në mbërritje, duke u futur në ujërat territoriale greke, Moisiu i udhëzoi ata për rrugën që duhet të ndiqnin kur të linin molin, konkretisht: “...tani që do ikësh... duhet të largohesh dy milje nga këtu ... nga toka... dhe pastaj duhet të ikësh dy milje nga toka ... vazhdo vetëm drejt ... sapo të mbarojnë dritat tona ... se tani më mori në telefon polici që më sqaroi ... që mos t’u afrosh ujërave greke ... duhet të ecësh vetëm drejt ... kur mbarojnë dritat sepse kur arrin në një pikë pas 6-7 miljesh nuk shihen më dritat – duhet të ecësh edhe 2-3 milje të tjera ... dhe pastaj hyn ...”.

Më poshtë, gjykata sjell të plota rezultatet e përgjimit:

Përgjime ambientale në bordin e Peshkarexhës “Fatima” 3SR877”, në përdorim të Rosario Giulianos dhe Giuseppe Grecos – RIT 1354/14 – Regjistrimi ambjental 11004 i orës 02:18:18 të datës 06.05.2015

Peshkarexha ka ndaluar në Porto Palermo në Shqipëri (koordinatat 400636083 - 197926733) dhe brenda saj ndodhen Rosario Giuliano (R) dhe Giuseppe Greco (G). Dëgjohen dy peshkatarët që flasin mes tyre me zë të ulët. Në orën 02:22:15 mbërrin Moisi Habilaj (M) dhe midis tyre zhvillohet biseda: “M: Saro G: Po. M:... (e pakuptueshme)...G: Çfarë? M: (e pakuptueshme)...G: Pse? M: Jo sepse po presim.G: Jo, jo ... po kontrollojmë ujin në serbatorin e varkës. M: Çdo gjë në rregull? G: Në rregull. M: Eej ... tani në fillim të bëjmë naftën ... të sjellim naftën.G: Po. M: Fillojmë me bidonat. G: Po. M: Sepse nuk keni bidona lart. G: Mirë. M: Mirë dhe pastaj... dhe pastaj ngjiti. R: Ku duhet të ngjitemi? M: (qesh)...Hipi ...(e pakuptueshme) R: Duhet të nxitojmë ...se duhet të ikim vëlla ... (qesh) ... duhet të ikim. M: Po vëlla, ne duhet t’i bëjmë gjërat ashtu siç duhen bërë. R: Dëgjo një gjë. M: Më thuaj. R: Policia ... kjo këtu...M: Po R: Është në det tani? M: Ata përbindëshat!? R: Po M: Janë në det... mos ki merak. R: Po pastaj do u’a thuash ama kur të dal. M: Mos ki merak ... nuk..R: Në rregull. M: Këtu je si në shtëpinë tënde ...boll!

Dëgjohej Rosario që i drejtohet Giuseppe dhe thotë: R: Pippo...po humbet ujë? G: (e pakuptueshme)... M: Shiko çfarë bëhet tani? R: Një m...M: Çfarë? R: Një m...M: (e pakuptueshme)... duke qënë se duhet të nisesh në orën katër ... sepse të tjerët dalin në katër e gjysëm ... ti del në katër ... pastaj nëse duhet ... sepse nuk i dihet asnjëherë ... furgoni ... (e pakuptueshme)... është i ngarkuar ... po pres vetëm një zile ... nuk i dihet kurrë ... në fillim marrim naftën dhe pastaj jemi në rregull. ... nëse vjen dikush... përse duhet të rrimë ngarkuar dy orë me mutin sipër... më kuptove?...sepse kush e di kush drejtin vjen.. kush ikën... por ne jemi të kompletuar ama ... del ndonjë bastard”.

Në vijim, në orën 02.24.36, flasin për orarin dhe për faktin që duhet të presin akoma një orë e gjysëm: “M: E di se çfarë duhet të gjesh? ... Francesco (Rosarion e quan Francesco)... duhet të gjesh një gjë ... si quhet kjo?... zinxhir ... jo zinxhir R: Litar? M: Një litar ... i bëjmë pesë e pesë bidonat ... dhjetë e dhjetë ,, dhe i lidhim njëherë kur të nise mi ... e kuptove?...i zbrazim ... i ngjeshim dhe i provojmë pesë e pesë ... dhjetë e dhjetë... e kuptove?... a e pe furgonin e policisë që kaloi pak më parë? R: Ai me drita të bardha ... apo jo? M: Shkoi andej apo këtej? R: Andej ... ai atje që të thashë unë ... është makina ... (e pakuptueshme)... ai ishte ai i yni? M: Të gjithë tanët janë këtu! ... por del ndonjëherë ndonjë trap si dihet! (vazhdon në mënyrë të pakuptueshme sepse Moisiu flet me zë shumë të ulët).

Vazhdimi i bisedës: “M: Sepse nuk e dinë të gjithë këtë ... prandaj të them unë që ... duhet të rrimë 2 orë të ngarkuar me m... sipër... 5 minuta “pam pam” dhe ikën ... këtu jam unë ... jemi 6 persona ... 7 persona ... jemi ne 4 vëllezërit ... jemi sot këtu ... djali që ishte këtu doli tani nga “Piazza Lanza” (i referohet Sabaudin Çelajt, shënim i hartuesit) ... ka një muaj ... ka një muaj që ka dalë ... ka dalë me arrest shtëpie... shkova dhe e morra ... dhe e solla këtu... dhe dy nipërit e mi të tjerë ... nuk ka persona të tjerë këtu ... nëse na ndodh ndonjë gjë e tillë minimumi do vdesin 20 vetë ... minimumi ... si minimum ... (duke qeshur)... fillojmë me minimumin ... (pauzë) peshkuat?... jo. R: Nesër apo pasnesër do të bëjmë parangallin ... (e pakuptueshme) kemi karremin. G: Karremin? M: Çfarë? R: Karremin M: Karremin...çfarë është? R: Sardele? M: Jo, çfarë drejtin...M: Ai mori në telefon se është salla ... si thuhet?... salla është në portin tjetër në kryeqytet ... ku janë ... (e pakuptueshme) ... dhe shikon çdo gjë ... edhe peshqit shikon nga atje ... sepse është shok i një shokut tonë “po si ka mundësi” ... përse e pyete “kush është kjo anija?” ... dhe ai tha “çfarë anijeje” (e pakuptueshme)... “po si ka mundësi që hyri një milje në ujërat territoriale greke?”...G:... çfarë kishte thënë? M: Si ka mundësi kjo anije ...kjo peshkarexhë që hyri një milje ... në ujërat territoriale greke” ... sepse ai tha “kaloi në ujërat territoriale greke” .. nuk e di çfarë gënjeshtërash i ka thënë .. nga drejtin ta di...”.

Më pas Rosario pyet Moisiun për rrugën që duhet të bëjnë në kthim: “M: Ti duhet të marrësh tani që këtu ...duhet të dalësh...djathtas, drejt ... le të themi ... dil këtu ... si jemi ... si erdhëm... po pak... R: Më djathtas? M: Po, më djathtas ... ishullin e madh duhet ta kalosh nga ana tjetër...”.

Përgjime ambientale në bordin e Peshkarexhës “Fatima” 3SR877” në përdorim të Rosario Giulianos dhe Giuseppe Grecos – RIT 1354/14 – Regjistrimi ambiental 11005 i orës 02.48.20 datë 06.05.2015.

Peshkarexha ka ndaluar në Porto Palermo në Shqipëri dhe, brenda saj, ndodhen Rosario Giuliano (R) dhe Giuseppe Greco (G), Moisi Habilaj, Florian Habilaj dhe burra të tjerë shqiptarë. Dëgjohej disa zhurma brenda peshkarexhës. Në orën 02.48.50 Moisi Habilaj (M) pyet Rosarion nëse është lodhur dhe biseda vazhdon: “M: Saro R: Çfarë? M: Më dëgjo mirë

vëlla. R: Më thua. M: Tani që do të ikësh duhet të largohesh dy milje nga këtu ... nga toka... dhe pastaj duhet të ikësh dy milje nga toka ... vazhdo vetëm drejt ... sapo të mbarojnë dritat tona ... se tani më mori në telefon polici që më sqaroi ... që mos t'u afrosh ujërave greke. R: Atëherë unë ... më ndiq... unë po dal që këtej M: Merr djathtas. R: Të shkoj kështu? M: Po. R: Dhe gjithë dritat që janë këtu të bëj ... 2/3 milje. M: Po ... larg nga drita ... 2 milje R: Dy milje. M: Po., duhet të ecësh vetëm drejt ... kur mbarojnë dritat sepse kur arrin në një pikë pas 6-7 miljesh nuk shihen më dritat ... duhet të ecësh edhe 2-3 milje të tjera ... dhe pastaj hyn ...R: Pastaj të kthehem majtas. M: Drejt Italisë ... kuptove?... nuk duhet të gabosh vëllai im. R: Jo jo”.

IV. Pretendimet e prokurorit dokumentuar në kërkesën për gjykim.

Nga aktet e administruara në funksion të hetimit të procedimit penal Nr.134 Viti 2016, ekziston dyshimi i arsyeshëm dhe i bazuar në prova, se shtetasi Jaeld Çela, ish Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë, në bashkëpunim me efektivet e policisë, Sokol Bode, Gjergji Kohila dhe, shtetasit Moisi Habilaj, Florian Habilaj, Artan Habilaj, Armand Koçerri, etj. kanë kryer veprat penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, “Trafikimi i narkotikëve”, në bashkëpunim, në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, të parashikuara nga nenet 284, 283/a dhe 333/a të Kodit Penal.

Nuk ka shkaqe padënueshmërie ose të shuarjes së veprave penale të sipërcituara. Subjektet nën hetim, shtetasit Jaeld Çela dhe Gjergji Kohila janë persona madhorë, pra kanë moshën për përgjegjësi penale dhe janë të përgjegjshëm para ligjit, ndërsa fakti penal, objekt i këtij hetimi, parashikohet nga ligji penal në fuqi, nga nenet 284, 283/a, 333/a të Kodit Penal.

Ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, në funksion të hetimit të kësaj çështje, pasi organi procedues po zhvillon hetime edhe në drejtim të personave të tjerë të përfshirë në këtë grup kriminal të trafikimit të narkotikëve. Këta të fundit janë ende të pidentifikuar dhe nëpërmjet tyre personat nën hetim Jaeld Çela dhe Gjergji Kohila mund të ndërhyjnë dhe të ndikojnë në prishjen, asgjësimin e provave apo mund të vështirësojnë mbledhjen e tyre, për dokumentimin e plotë të rrethanave të faktit të ndodhur, bashkëpunëtorëve dhe rolit të secilit prej tyre në këtë aktivitet kriminal ndërkombëtar. Në ekzistencën e këtij kushti ndikon edhe fakti që tashmë është bërë publik kryerja e hetimeve në drejtim të anëtarëve të grupit kriminal si nga organi procedues italian, ashtu edhe ai shqiptar.

Ekziston rreziku që të largohen personat nën hetim Jaeld Çela dhe Gjergji Kohila, për t'i shpëtuar drejtësisë. Organi procedues ka nxjerrë, ndaj tyre, urdhër ndalimi dhe, nga kërkimet e policisë nuk është bërë i mundur ekzekutimi si rezultat i largimit dhe fshehjes. Po ashtu, nisur nga rrezikshmëria shoqërore e veprave penale si dhe, nga sanksioni që parashikohet për to (nga dhjetë gjer në njëzet vjet burgim për njëren vepër penale dhe nga dy deri në tetë vjet burgim për tjetrën), rreziku i largimit është evident për t'i shpëtuar dënimit të tyre, siç edhe ka ndodhur faktikisht. Dyshohet se shtetasit nën hetim janë larguar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe, në këto kushte, duhet bërë kërkimi ndërkombëtar.

Në kërkesën për caktimin e masës së sigurimit organi procedues mban parasysh rrezikshmërinë e veprave penale, sanksionin me burgim, shkallën e nevojave të sigurimit, raportin e drejtë mes rëndësisë së faktit dhe sanksionin që parashikohet për veprat penale, formën e veçantë të bashkëpunimit. Duke patur parasysh rrezikshmërinë e veçantë të veprave penale dhe të autorëve të saj, më e përshtatshme për personat nën hetim Jaeld Çela dhe

Gjergji Kohila është caktimi i masës së sigurimit “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

V. Vlerësimi i gjykatës

V.Kërkesa me objekt caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” ndaj shtetasve nën hetim Jaeld Çela dhe Gjergji Kohila duhet të pranohet sepse ekzistojnë kushtet dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për caktimin e saj, të parashikuara në nenet 228, 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale.

Mbi shtetasit nën hetim ekziston dyshimi i arsyeshëm për kryerjen prej tyre, të veprave penale për të cilat po procedohet.

Fakti i qënies së shtetasit Jaeld Çela me detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Policisë Vendore Vlorë gjatë periudhës së dokumentuar si periudhë e ushtrimit të aktivitetit të kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike, i rezultuar nga prova dokument, organika e Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë; fakti i konstatimit të parcelave të mbjella me sasi të konsiderueshme bimësh narkotike të llojit Cannabis Sattiva, rezultuar nga veprimet e kqyrjes dhe sekuestrimit; të dhënat e përfuara nga tabulatet telefonike të marra nga Kompania “Vodafone”, sipas të cilave Jaeld Çela pati komunikime telefonike me Florian Habilaj, Orest Sota dhe Gentian Çeka (të rezultuar këta dy të fundit në episodin e sekuestrimit të sasisë prej mbi 800 000 Euro në mjetin ku ndodheshin, gjithashtu, dokumenta personale të shtetasit Saimir Tahirit); të dhënat e përfuara nga komunikimet telefonikë të personave të përfshirë në kultivimin e narkotikëve, rezultuar nga Akti i Ekspertimit Teknik Nr.2273 datë 09.03.2017, sipas të cilave u fol për mbështetjen e drejtorit në ushtrimin e aktivitetit të tyre, të vlerësuara në unitet me rezultatet e përgjimeve ambjentale, kryer në Peshkarexhën “Fatima”, në datë 06.05.2015, sipas të cilëve Moisi Habilaj siguroi dy shtetasit italianë për mosndërhyrjen e policisë lokale, për shkak të raporteve të krijuara me të, **çmohen të afta për të provuar dyshimin e përfshirjes së shtetasit Jaeld Çela në rolin e bashkëpunëtorit, në veprimtarinë kriminale të kultivimit dhe trafikimit të narkotikëve, të kryer në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuara si vepra penale në nenet 284, 283/a e 333/a të Kodit Penal.** Duke qënë me detyrën e Drejtorit të Policisë Vendore Vlorë, shtetasi Jaeld Çela i siguroi kultivuesve dhe trafikantëve të lëndëve narkotike mbështetjen e tij dhe të gjithë forcave policore në varësi të tij për vazhdimësinë e aktivitetit, nëpërmjet shmangies së veprimit të ligjit.

Fakti i qënies së shtetasit Gjergji Kohila Shefi i Sektorit për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafikeve në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, i rezultuar nga prova dokument, organika e Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë; fakti i konstatimit të parcelave të mbjella me sasi të konsiderueshme bimësh narkotike të llojit Cannabis Sattiva, rezultuar nga veprimet e kqyrjes dhe sekuestrimit; të dhënat e përfuara nga tabulatet telefonike të marra nga Kompania “Vodafone”, sipas të cilave Gjergji Kohila pati komunikime telefonike me Artan Habilaj; të dhënat e përfuara nga komunikimet telefonikë të personave të përfshirë në kultivimin e narkotikëve, rezultuar nga Akti i Ekspertimit Teknik Nr.2273 datë 09.03.2017, sipas të cilave Gjergji Kohila informoi organizatorët e kultivimit për procedimin penal të nisur dhe udhëzoi të bënin kujdes në lëvizjet e tyre dhe me aparatet telefonikë; duke fikur të gjithë ata me të cilët kishin komunikuar në funksion të kryerjes së veprimtarisë kriminale, të vlerësuara në unitet me rezultatet e përgjimeve ambjentale, kryer në Peshkarexhën “Fatima”, në datë 06.05.2015, sipas të cilëve Moisi Habilaj siguroi dy shtetasit italianë për mosndërhyrjen e policisë lokale, për shkak të raporteve të krijuara me të, **çmohen të afta për të provuar**

dyshimin e përfshirjes së shtetasit Gjergji Kohila në rolin e bashkëpunëtorit, në veprimtarinë kriminale të kultivimit dhe trafikimit të narkotikëve, të kryer në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuara si vepra penale në nenet 284, 283/a e 333/a të Kodit Penal. Duke qënë me detyrën e Shefit të Sektorit për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiqeve, shtetasi Gjergji Kohila i siguroi kultivuesve dhe trafikantëve të lëndës narkotike mbështetjen e tij dhe të gjithë forcave policore në varësi për vazhdimësinë e aktivitetit, nëpërmjet shmangies së veprimit të ligjit.

Nisur nga numri i personave të përfshirë në aktivitetin e kundraligjshëm të trafikimit të narkotikëve që gjeneron përfitime materiale, nga shtrirja e aktivitetit në kohë dhe hapësirë, nga sasitë e konsiderueshme të lëndëve narkotike të sekuestruara në Itali dhe në Shqipëri, gjykata çmon se bashkëpunimi midis shtetasve nën hetim, duke përfshirë edhe shtetasit Jaeld Çela dhe Gjergji Kohila nuk është i rastësishëm. Në nivelin e provave të grumbulluara deri në këtë fazë hetimi, rezulton ekzistenca e një bashkëpunimi në formën e grupit të strukturuar kriminal, për kryerjen si të veprës penale të kultivimit të narkotikëve ashtu edhe të trafikimit të tyre, ku shtetasit nën hetim Jaeld Çela dhe Gjergji Kohila, duke shfrytëzuar funksionet e tyre drejtuese në strukturat e policisë, në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, nëpërmjet shmangies së zbatimit të ligjit në përgjithësi dhe shmangies së ndërhyrjes së policisë në veçanti, mbështetën aktivitetin e kultivimit dhe trafikimit të narkotikëve dhe siguruan vazhdimësinë e tij në kohë dhe hapësirë. Ky konkluzion i gjykatës është në pajtim me parashikimin në nenin 28 pika 4 të Kodit Penal sipas të cilit: *„Grupi i strukturuar kriminal është formë e veçantë bashkëpunimi, në të cilin bëjnë pjesë tre ose më shumë persona, për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jomateriale. Grupi i strukturuar kriminal, për kryerjen e një veprë penale, nuk formohet rastësisht e nuk është e nevojshme të dallohet për anëtarësi të qëndrueshme, ndarje detyrash, organizim dhe strukturim të zhvilluar“.*

Për sa më sipër, gjykata çmon të plotësuar kushtin themelor të përgjithshëm për caktimin e masave të sigurimit personal, i parashikuar në nenin 228 pika 1 e Kodit të Procedurës Penale: *“Askush nuk mund t’u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova”.* Ky rregullim ligjor është sanksionuar në zbatim të parimit të rëndësishëm të parashikuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në nenin 27 pika 2 gërma „c“ të saj si dhe, në nenin 5 gërma „c“ të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

Në arritjen e konkluzionit të mësipërm, gjykata mban parasysh edhe arsyetimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në Vendimin Unifikues Nr.7 datë 14.10.2011, sipas të cilit: *„...dyshimi i arsyeshëm, provat ku ai bazohet për të justifikuar caktimin dhe vijimin e zbatimit të masës së sigurimit, nuk nevojitet të ketë të njëjtën shkallë sigurie dhe vlerë provueshmërie për të konkluduar sikurse provat që janë të domosdoshme për dhënien ose jo të vendimit të dënimit ndaj të pandehurit. Mjafton që ato të jenë të tilla që, në gjendjen ku janë aktet e procedimit, prej tyre mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit a të gjykuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie e fajësisë për kryerjen e veprës penale në ngarkim të tij...“.*

Gjatë gjykimit të kërkesës nga gjykata nuk u konstatua ekzistenca e ndonjë rrethane padënueshmërie apo shuarje e veprës penale. Shtetasit Jaeld Çela dhe Gjergji Kohila rezultojnë se kanë moshën për përgjegjësi penale dhe paraqiten me një ekuilibër mendor të tillë (rezultuar nga aktet) që nuk vë në dyshim përgjegjshmërinë e tyre para ligjit, ndërkohë

që veprat penale, për të cilat dyshohen, janë të dënueshme nga ligji material penal në fuqi. Vlerësohet i plotësuar, në këto rrethana, edhe kushti i dytë i përgjithshëm për caktimin e masave të sigurimit personal, i parashikuar në nenin 228 pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit: *“Asnjë masë nuk mund të zbatohet kur ka shkaqe padënueshmërie ose të shuarjes së veprës penale”*.

Për caktimin e një mase sigurimi personal, krahas dy kushteve të përgjithshme të trajtuara sa më sipër, duhet të ekzistojë të paktën njëri prej kushteve të veçanta të parashikuara në nenin 228 pika 3 e Kodit të Procedurës Penale (duke qënë zbatimi i tyre alternativ dhe jo akumulativ).

Duke vlerësuar rolin e luajtur nga shtetasit nën hetim Jaeld Çela dhe Gjergji Kohila, në unitet me shtrirjen në kohë dhe hapësirë të aktivitetit kriminal të kultivimit dhe trafikimit, në të cilin dyshohen të përfshirë disa persona, të organizuar në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal si dhe, me faktin që hetimi është në vazhdimësi dhe ende nuk është bërë i mundur identifikimi i plotë dhe kapja e të gjithë të dyshuarve, gjykata çmon praninë e kushtit të veçantë të parashikuar në nenin 228 pika 3 gërma “a” i Kodit të Procedurës Penale (me ndryshimet e bëra në të me Ligjin Nr.35/2017) me përmbajtjen: *“kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethanat fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit”*. Për gjykatën, vazhdimësia e të qënurit i lirë për shtetasit Jaeld Çela dhe Gjergji Kohila përbën një mundësi reale për rrezikimin e procesit të të provuarit. Lënia në gjendje të lirë e tyre krijon mundësinë që ata, në bashkëpunim me personat e tjerë të përfshirë në krim, të bëjnë përpjekje për të fshehur prova që ende nuk janë gjetur apo marrë. Rreziku në këtë rast bëhet edhe më evident nisur nga fakti i publikimit të hetimeve që kryhen si në Shqipëri dhe në Itali.

Në analizë të rrethanave të faktit, **duke patur parasysh rrezikshmërinë e veprave penale, për kryerjen e të cilave dyshohet shtetasit nën hetim, sanksionin e parashikuar në dispozitat përkatëse** (për dy prej tyre nga dhjetë gjer në njëzet vjet dhe nga dy deri në tetë vjet), faktin që, pavarësisht nxjerrjes së urdhërave të ndalimit për shtetasit Jaeld Çela dhe Gjergji Kohila (datë 21.11.2017), ende nuk është bërë i mundur ekzekutimi i tyre për shkak të largimit, **gjykata çmon se shtetasit nën hetim janë larguar pikërisht për t’ju shmangur hetimit dhe përballjes me drejtësinë**. Pra çmohet i plotësuar një kusht tjetër i veçantë për caktimin e masave të sigurimit personal, i parashikuar në nenin 228 pika 3 gërma “b” e Kodit të Procedurës Penale, me përmbajtjen: *“Kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet”*.

Në lidhje me llojin e masës së sigurimit personal që duhet të caktohet ndaj shtetasve të dyshuar, gjykata mban parasysh kriteret e parashikuara në nenin 229 të Kodit të Procedurës Penale, të lidhura me nevojat e sigurimit, rëndësinë e faktit, sanksionin e parashikuar në dispozitën përkatëse dhe, me rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

Duke patur parasysh rrezikshmërinë e veprave penale të kultivimit dhe trafikimit të narkotikëve, e vlerësuar e lartë jo vetëm për shkak të raporteve juridike që çënon dhe sanksionit të parashikuar në dispozitat përkatëse por, edhe për shkak të përhapjes në shkallë vendi si dhe, formën e veçantë të bashkëpunimit në kryerjen e veprimtarisë kriminale, shfrytëzimin e funksionit shtetëror në kryerjen e rolit mbështetës bashkëpunues, mungesën e rrethanave lehtësuese, faktin e largimit, gjykata, bazuar në nenin 230 të Kodit të Procedurës Penale, çmon se masa më e përshtatshme e sigurimit personal të karakterit shtrëngues për shtetasit Jaeld Çela dhe Gjergji Kohila është ajo e arrestit në burg, e parashikuar si e tillë në nenin 238 të Kodit të Procedurës Penale. Caktimi i kësaj mase është në zbatim të parimit të rëndësishëm të proporcionalitetit, në mbrojtje të interesit të shoqërisë dhe të parandalimit të posaçëm.